

Opinion&Komente

Të rinjtë e Kosovës, orientim drejt vlerave konservatore apo liberale?



Brikena Avdyli

Rinia e Kosovës shpesh e gjen veten në mes të vlerave konservatore

Vlerat e rinisë së Kosovës nuk reflektojnë vetëm vlerat tona aktuale, por na tregojnë edhe një pasqyrë se ku do të jetë Kosova në të ardhmen. Të rinjtë e sotëm do t'i edukojnë fëmijët e tyre me përafërsisht të njëjtat vlera me të cilat janë rritur ata vetë, vlera të cilat janë pjesë e identitetit të tyre. Por çfarë janë këto vlera dhe ku qëndrojnë këto brenda spektrit të gjerë në mes të vlerave konservatore dhe atyre liberale?

Rinia e Kosovës shpesh e gjen veten në mes të vlerave konservatore që trashëgon nga familja dhe rrethi dhe atyre liberale që zakonisht u vijnë nga jashtë përmes ekspozimit direkt apo indirekt. Në shumë raste nuk ka nevojë të dilët jashtë Kosovës për të parë këtë dallim. Vlerat e të rinjve nga vendet më rurale, edhe vlerat e të rinjve të vendeve urbane janë shumë ndryshe prej atyre me të cilat ata/ato janë rritur. Por,

Sallonet e së Martës janë një nisim i avorë e Institutit Demokratik për Zhvillim (D4D) Saloni ka format Fyshitonatai Spas: rezulues "Chaitian House" dhe pa prau të mëdave Diskutimi mbledhjeve të vites ekspertë e analistë politikane e publikistë për të reflektuar dhe për të kërkuar konsen- jas mbi temat e përgjithshme. Fjala e hapjes postohet në www.youtube.com/user/TuesdaySalon

të rinj hezitojnë të veprojnë ndryshe. Në anën tjetër, për shkak të faktorëve të ndryshëm si: globalizimi, politika dhe feja, vlerat ndryshojnë vazhdimisht brenda spektrit të vlerave konservatore dhe liberale. Në Kosovë kemi disa ndryshime drejt vlerave liberale dhe nëse shikojmë prapa vërejmë se në disa fusha jemi bërë më të hapur. Dikur vajzat nuk janë dërguar në shkollë, ndërsa sot në universitete të Kosovës ka më shumë vajza sesa djem. Dikur çiftet kanë bashkëjetuar vetëm pas martesës dhe zakonisht martesë është bërë në mes të të rinjve të familjeve homogjene. Sot në shumë pjesë të Kosovës të rinjtë mund të bashkëjetojnë para martesës ose të martohen me persona të kombësive të tjera pa u paragjykuar. Ndryshime të tilla po ndodhin gradualisht, pavarësisht rezistencës për ta mbrojtur traditën dhe

nga familja dhe rrethi dhe atyre liberale që zakonisht u vijnë nga jashtë përmes ekspozimit direkt apo indirekt. Në shumë raste nuk ka nevojë të dilet jashtë Kosovës për të parë këtë dallim.

ne shumicën e rasteve ky dallim është vetëm sipërfaqësor dhe reflektohet me dallim në stil të veshjes, si dhe dalje më të shpeshta në qytet, duke përfshirë daljet në mbrëmje. Në thelb, vlerat me të cilat rrinia e Kosovës udhëheq jetën e tyre mbesin vlera konservatore të thelluara në traditë. Shumica e të rinjve janë më të mbyllur ndaj vlerave ndryshe, duke përfshirë barazinë gjinore, si dhe pranimin dhe ndërveprimin me komunitete të ndryshme. Në disa raste, edhe sikur të besojnë në këto vlera, nuk ballafaqohen me sfida që kërkohet për t'i mbrojtur ato para rrethit të tyre. Duke qenë se veprimet e tyre diktohen nga rrethi, ata/ato vazhdojnë me të njëjtat vlera dhe bien tamam në shabllonin e paracaktuar për ata/ato. Kjo është norma, edhe pse ka përjashtime.

Ndryshimi i kësaj norme është sfida. Për shkak të zhvillimit të dobët ekonomik dhe të papunësisë së të rinjve, që sipas disa statistikeve është deri në 60%, të rinjtë janë të varur financiarisht nga familjet e tyre. Shumica e tyre zgjedhin të jetojnë me familje. Po edhe sikur të donin ndryshe në këto kushte ata/ato do të kishin vështirësi të mbanin veten financiarisht. Jeta me familje në shumicën e rasteve ofron më pak hapësirë për ta definuar veten dhe vlerat individuale. Si rezultat, të rinjtë trashëgojnë vlerat e paraardhësve të tyre, që zakonisht janë më konservatore dhe mënyra e të jetuarit që ne e konsiderojmë "normale" është krijuar nga këto vlera. Dhe duke qenë se Kosova është e vogël dhe në një mënyrë ose tjetër të gjithë dalim të njohshëm, çdo dalje jashtë kësaj "normaleje" rrezikon paragjykimin jo vetëm të personit, po edhe të familjes së tij/saj. Kjo është edhe një arsye pse shumë

et me një artikull
të cilin përbëjnë
në gazetën "Zeri" të
marrjen e ardhshme
Podcastet bazuar në
editoarialet mund të
gjenen në www.zeri.info
dhe, gjithashtu, podcast-
et për satelit. A jeni
një spektator apo
një lektues? Ose
mbështetës? Për
detaje, shikoni

<http://www.zeri.info>
/opinione

like >
[facebook.com/gazetazeri](https://www.facebook.com/gazetazeri)
follow >
twitter.com/gazeta_zeri



> Në këtë hapësirë, "Zeri" boton opinionione, analiza, vështrime, qasje, reagime dhe letra të lexuesve. Shkrimet nuk duhet të jenë më të gjata se 800 fjale

> Redaksia mban të drejtën e shkurtimeve të materialeve të kësaj rubrike, apo edhe të mosbotimit të tyre, në rast se shkrimet për këtë rubrikë janë joprofesionale dhe joetike. Redaksia nuk qendron prapa opinionioneve që botohen në këto faqe.

Për gjeneratat e ardhshme këto do të jenë pjesë e asaj që ata do ta konsiderojnë "normale".

Pavarësisht ndryshimeve graduale, të rinjtë vazhdojnë të mbesin në udhëkryq, në mes të vlerave konservatore të trashëguara dhe vlerave liberale, që në shumicën e rasteve vijnë nga jashtë. Në mes të dyjave shumica e të rinjve zgjedhin të vazhdojnë traditën, pasi që familja dhe vlerat e trashëguara janë pjesë integrale e identitetit tonë. Disa vlera nga jashtë mund të jenë liberale si dhe të nevojshme, në mënyrë që të rinjtë e Kosovës të jenë më të hapur, sidomos në trajtimin e barabartë të të gjitha grupeve të marginalizuara. Por ato e kanë të vështirë të fitojnë në garë me traditën. Për këtë arsye ndryshimet thelbësore në zhvillim të rinisë mund të vijnë vetëm kur punohet edhe me rrethin njëkohësisht. Nga ky bashkëpunim mund të krijohen vlera që janë kompromis i vlerave konservatore të trashëguara dhe vlerave liberale, të cilat do të përputhen me identitetin e të rinjve të Kosovës. Kështu do të krijohen vlerat në mënyrë më organike dhe jo në formatin e importimit të vlerave të popujve që mund të jenë shumë ndryshe nga populli i Kosovës.

Në fund të fundit, për shkak të globalizimit edhe vlerat, të cilat i mbajmë afër zemrës si vlera tradicionale, mund të ndryshojnë. Gradualisht, në familje të Kosovës dikush nga gjeneratat e reja mund të thyejë disa vlera tradicionale dhe të adoptojë vlera të tjera. Por në përgjithësi, përderisa vazhdojmë të kemi këtë lidhje të ngushtë me familje, gjë që na veçon për të mirë, vlerat e të rinjve të sotëm, të cilat do të përcillen edhe tek fëmijët e tyre, do të jenë më shumë konservatore.